

STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ Passion Fashion & Co ”

Ne baze e ne zbatim te ligjit

- Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” me poshte referohet si “Ligi Per Shoqerite”,
- Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit”;
- Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”;

veprimitaria e shoqerise

“ Passion Fashion & Co ” sh.p.k.

do te organizohet dhe do te drejtohet sipas ketij Statuti te trajtuar ne te njejtien dokument me Aktin e Themelimit.

PJESA E PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1
Ortaket

1.1 Ortaket e shoqerise jane :

1. **Oltjana Munega**, shtetase Shqiptare , lindur me 04/10/1984 ne Korce, banuese ne Tirane, Shqiperi , mbajtese e leternjoftimit nr. BD2712604 dhe numer personal **I46004054T** , madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

Neni 2
Emri

Emri i shoqërisë është **Passion Fashion & Co sh.p.k.** (më poshtë referuar si “Shoqëria”).

Neni 3

Selia e Shoqerise

- 3.1 Selia e Shoqerise eshte ne adresen: **“Tirane, Zona Kadastrale 3866 ,Rruga Sokrat Miho, Kashar ,Godine banimi dhe sherbbimesh 1-7-9kate + 1 kat parkim nentok , Kati i pare.**
- 3.2 Shoqëria mund te hapë degë, zyra përfaqësimi brenda apo jashtë Republikes se Shqipërisë ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.

1


Neni 4
Forma ligjore

4.1. Shoqëria është shoqëri shqiptare dhe është krijuar si **shoqëri me përgjegjësi të kufizuar**.

Neni 5
Kohëzgjatja

5.1. Shoqëria do te ushtroje aktivitetin e saj tregtar per një periudhe te pacaktuar (pakufizuar).

Neni 6
Objekti i aktivitetit

Objekti i veprimtarise se shoqerise “**Passion Fashion & Co**” sh.p.k, konsiston ne :

1. Prodhim veshje pune, Rrobaqepsi, Sherbime Fason, Tregtim me shumice dhe pakice te veshjeve te ndryshme, si dhe çdo lloj tjeter aktiviteti qe eshte i lejuar nga Legjislationi Shqiptar.
- 6.2. Shoqeria mund te kryeje edhe aktivitete te tjera shtese, me qellim permbushjen e veprimtarise te saj kryesore ne perputhje me legjisacionin shqiptar ne fuqi.

PJESA II
KAPITALI I SHOQËRISE DHE KUOTAT

Neni 7
Kapitali i Shoqërisë

Kapitali i shoqerise eshte 100,000 (njeqind mijë) Lek i marre persiper dhe i nenshkruar nga ortaket.

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 1 (nje) kuote e cila zoterohej nga ortaket si me poshte :

Ortaku	Kuotat e Nenshkruara	Vlera ne Leke	Perqindja(%)
Oltjana Munega	1	100,000	100%
Total	1	100,000	100%

Kapitali themeltar eshte vetem ne monedhen vendase, lek.



III. STRUKTURA DREJTUESE TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 8 Përgjegjësia e kufizuar

8.1. Ortaket jane përgjegjës deri në vlerën e pjesës së tyre në kapitalin e Shoqërisë. Shoqëria është përgjegjëse për detyrimet e saj me të gjitha asetet.

Neni 9 Të drejtat e lidhura me cdo kuotë

9.1. Cdo kuote e secilit ortak do t'i përgjigjet një vote korresponduese në mbledhjet e ortakëve dhe do t'i japë ortakëve të drejtën për të marrë dividendë në rast shpërndarje të fitimit si dhe të drejtën e pjesës përkatëse që mbetet pas procedurave të likuidimit në rast prishje apo likuidimi të Shoqërisë.

Neni 10 Fitimi dhe kalimi i kuotave

- 10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. kontibutin ne kapitalin e shoqerise;
 - b. shitblerjes;
 - c. trashegimise
 - d. dhurimit
 - e. cdo menyre tjeter parashikuar me ligj.
- 10.2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata do behet me shkrim.

Neni 11 Detyrimet e Ortakëve

11.1 Ortakët kanë detyrim të paguajnë pjesën e tyre, të marrin pjesë në mbledhjet e asamblesë nëse ftohen në mënyrën e duhur, të mbështesin Shoqërinë në kryerjen e veprimeve të saj si dhe të përbushin vendimet e mbledhjes së ortakëve dhe organeve të tjera të Shoqërisë të cilat janë marrë në mënyrën e duhur brenda qëllimit të organit përkatës.



PJESA IV
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 12
Të drejtat e asamblesë së pergjithshme

- 12.1 Asambleja e pergjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë e cila ka të drejtë të marrë vendime në lidhje me të gjitha cështjet e veprimtarisë së saj.
- 12.2 Asambleja e pergjithshme përbëhet nga të gjithë ortakët.
- 12.3 Vetëm asambleja e pergjithshme ka të drejtë të vendosë për sa më poshtë:
- (a) ndryshime dhe modifikime të Statutit;
 - (b) pranimin e ortakëve të rinj (pas rritjes së kapitalit apo transferimit të kuotave);
 - (c) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit dhe/ose cdo lloj pagimi të pjesshëm ose subvencionii të dhënë nga ortakët;
 - (d) bashkimin, ndarjen, prishjen dhe cdo lloj transformimi të Shoqërisë;
 - (e) blerjen apo disponimin e interesit pjesëmarrës në shoqëri shqiptare apo të huaja;
 - (f) hapjen dhe mbylljen e degëve dhe zyra e përfaqësimit;
 - (g) pjesetimin dhe anullimin e kuotave;
 - (h) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - (i) miratimin e raporteve vjetore dhe bilancit të shoqërise si dhe shpërndarjen e fitimit;
 - (j) blerjen, shitjen dhe dhënien peng të pasurive të paluajtshme;
 - (k) marrjen me qira, dhënien me qira ose dhënien e cdo të drejtë për përdorimin e pasurive të paluajtshme dhe ndërtesave;
 - (l) të vendosë për investimet;
 - (m) të japë letra me vlerë, të marrë detyrime, të lëshojë garanci ose letra sigurie
 - (n) të përcaktojë parimet e përgjithshme të politikave të shoqërisë;
 - (o) të caktojë shpërbilimet për administratorët, të përfundojë kontratat e punës me administratorët dhe nëpunësit ekzekutivë të shoqërisë;
 - (p) të japë alternativa, të drejta të ndarjes së fitimit vjetor, pagesave në natyrë, të drejtat mbi pensionet ose cdo pagesë mbi largimin e drejtoreve, dhe nëpunësve ekzekutivë të shoqërisë;
 - (q) të përfundojë marrëveshje konsultimi dhe bashkëpunimi;
 - (r) emerimin dhe shkarkimin e likujduesve, ekspertëve kontabël te autorizuar;
 - (s) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - (t) percaktimin e shperblimeve per likujduesit, ekspertet kontabel;
 - (u) mbikqyerjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët;
 - (v) miratimin e rregullave të brendshme mbi administrimin dhe mbledhjes se asamblese;
 - (w) përcaktimin e strukturës organizative dhe administrative të Shoqërisë;
 - (x) përcaktimin e buxhetit vjetor;
 - (y) miratimin e cdo cështje tjeter zgjidhja e së cilës i është rezervuar asamblesë së pergjithshme në përputhje me ligjin dhe këtë Statut.



- (z) Marrjen e huave ne emer te shoqerise dhe vendosjen e kushteve te huase
- (aa) Lidhjen e mareveshjeve per dhenien e huave

12.4 Asambleja e per gjithshme do te ket te drejt te vendosë mbi cdo cështje që tejkalon aktivitetin e përditshëm te shoqërisë.

Neni 13
Vendimet e asamblesë se per gjithshme

13.1 Vendimet e renditura përsa i përket ndryshimit te statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit te regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë merren me $\frac{3}{4}$ e votave te ortakeve pjesëmarrës.

Neni 14
Thirrja e asamblesë se per gjithshme

- 14.1 Asambleja e per gjithshme do te thirret nga administratorët te paktën njëherë në vit në selinë e Shoqërisë ose ne cdo vend tjeter nëse percaktohet ne njoftim.
- 14.2 Gjithashtu, ortakët te cilet perfaqësojnë te paktën 20 për qind te totalit te votave ne asamblenë e përgjithshme te shoqërisë mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike për te thirrur asamblenë e per gjithshme. Në kërkesën drejtar administratorëve mund te përfshihen dhe cështjet e posacme te rendit te ditës.
- 14.3 Asambleja e per gjithshme do te thirret me anë te një njoftimi te shkruar te dërguar nga administratorët, njoftim ky i cili duhet te merret nga perfaqësuesit e ortakeve nëpërmjet një letre rekomande, email , telexi apo faksi jo më pak se 7 (shtatë) ditë përpëra datës se caktuar te mbledhjes. Njoftimi i shkruar do te regjistrohet në librin e procesverbalit te shoqërisë. Gjithashtu, asambleja e per gjithshme mund te thirret nëpërmjet postës elektronike me te njëjtat kushte dhe afate.
- 14.4 Njoftimi për takimin e asamblesë se per gjithshme do te trejgojë datën kohën dhe vedin e takimit si dhe cështjet e rendit te ditës.
- 14.5 Nëse data për mbledhjen e ardhshme te asamblesë është vendosur në takimin e fundit dhe te gjithë ortakët kanë qënë prezentë, atëherë do te gjykohet sikur njoftimi është dërguar.
- 14.6 Nëse te gjithë ortakët janë prezentë në asamblenë e ortakeve, atëherë vendimet mund te merren dhe në mungesë te përbushjes se kérkesave formale te caktuara më sipër nëse te gjithë ortakët janë dakord.

Neni 15
Vendimet e marra në asamblenë e per gjithshme

- 15.1 Vendimet në asamblenë e per gjithshme të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme mund të merren vetëm nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Vendimet në asamblesë e përgjithshme të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar mund të merrën vetëm nëse janë të pranishëm ortakët të cilët zotërojnë më shumë së gjysmën e numrit total të votave.
- 15.2 Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 15.3 Cdo ortak ka të drejtë të thërrasë këshilltarë në mbledhjen e asamblese, të cilat do të jenë të detyruar të ruajnë fshehtësinë e mbledhjes.
- 15.4 Nëse mbledhja e asamblese se per gjithshme thirret në mënyrë të rregullt por nuk plotësohet numri i ortakëve të caktuar për të përbushur kuorumin, atëherë asambleja do të thirret përsëri në përputhje me Nenin 14 dhe gjithmonë jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.

Neni 16
Drejtimi i mbledhjes se asamblese se per gjithshme

- 16.1 Kryetari i mbledhjes së asamblese se per gjithshme do të caktohet nga ortaket.
- 16.2 Do të aprovojen apo refuzohen vetëm ato cështje të cilat janë përcaktuar shprehimisht në rendin e ditës për mbledhjen e asamblese. Diskutimet mbi cështje të ndryshme nga ato të rendit të ditës mund të bëhen vetëm nëse të gjithë ortakët japid pëlqimin e tyre.

Neni 17
Procesverbali i mbledhjes së asamblese se per gjithshme

- 17.1 Për cdo mbledhje të asamblese se per gjithshme do të mbahet një procesverbal dhe do të merren vendime. Prosesverbali duhet të mbajë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit dhe të mbajtësit të procesverbalit dhe rezultatet e votimit. Një kopje e procesverbalit do të përgatitet për Shoqërinë, një për regjistrin tregëtar dhe një për secilin ortak. Prosesverbali i bashkangjitet edhe lista e pjesëmarrësve së bashku me aktin e thirrjes së asamblesë së përgjithshme.
- 17.2 Prosesverbali do të firmoset nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 17.3 Kopjet e vendimeve përkatëse të ortakëve do t'u dërgohen ortakëve me letër rekomande jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas takimit të ortakëve.



Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, një kopje e procesverbalit do të publikohet jo më vonë se 15 ditë nga data e mbledhjes në këtë faqe.

- 17.4 Administratori është përgjegjës për ruajtjen e kopjeve të procesvebalit dhe shpërndarjen e tij.

PJESA V ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 18 Administrimi i Shoqërisë

- 18.1 Administrimi i shoqërisë do të bëhet nga një ose me shume administratore, te cilet do te përfaqësojnë Shoqërinë. Gjithashtu, asambleja e pergjithshme mund të caktojë kompetenca përfaqësimi individuale secilit prej administratorëve.
- 18.2 Administratorët mund të autorizojnë palë të treta që t'i përfaqësojnë ata në transaksione të vecanta.
- 18.3 Administratorët do të organizojnë dhe menaxhojnë të gjithë aktivitetin e Shoqërisë. Ata janë të autorizuar të përfaqësojnë Shoqërinë në të gjitha cështjet që kanë lidhje me të.
- 18.4 Të drejtat dhe detyrimet e administratorëve burojnë nga ligji, ky Statut, vendimet e Asamblese se Pergjithshme dhe rregullat e brendshme të administritimit të Shoqërisë.
- 18.5 Administratorët kanë të drejtat e mëposhtme:
- (a) përfaqësimin e Shoqërisë kundrejt palëve të treta dhe shtetit;
 - (b) hapjen e llogarive bankare të Shoqërisë me bankat;
 - (c) përfundimin e marrëveshjeve me palët e treta, lëshimin dhe marrjen e urdhër pagesave;
 - (d) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, nxjerrjen e faturave, transferimet në monedhë të huaj, fletë ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e letrave me vlerë nga palët e treta;
 - (e) mbledhjen e detyrimeve që i takojnë shoqërisë, dhëniend dhe marrien e paradhënieve;
 - (f) dhëniend e moratoriumit debitorëve të Shoqërisë, heqjen dorë nga paditë që vijnë si pasojë e marrëdhënieve të Shoqërisë me palët e treta dhe/ose pranimin e këtyre padive;
 - (g) punësimin dhe shkarkimin e stafit të Shoqërisë, përcaktimin e pagave, shpërblimeve dhe pagesave të stafit;
 - (h) marrjen e masave paraprake për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë, fillimin e padive dhe marrjen përsipër të mbrojtjes së Shoqërisë në rast të padive kundër saj; administratorët mund të udhëzojnë avokatët të mbrojnë Shoqërinë dhe mund të përcaktojnë shumën e shpërbimit të



- tyre; administratorët kanë të drejtë të ngrenë padi dhe t'i tërheqin ato, të nënshkruajnë marrëveshje gjyqësore, të mbyllin marrëveshje arbitrazhi, të caktojnë arbitra, të tërheqin paditë e ngritura nga Shoqëria dhe të ndërprenjë procedimet;
- (i) administratorët kanë të drejtë marrin cdo vendim tjetër që i takon aktivitetit të përditshëm të Shoqërisë nga pikëpamja e ligjit dhe këtij Statuti;
 - (j) mbledhjen e shpenzimeve të Shoqërisë;
 - (k) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e llogarive në përputhje me ligjin dhe parimet e ligjit;
 - (l) administratorët janë përgjegjës për përgatitjen dhe nënshkrimin e bilancit vjetor dhe pasqyrave vjetore financiare të Shoqërisë dhe kontrollin e tyre nga një auditor i jashtëm nëse dicka e tillë kërkohet nga ligji apo vendimi i mbledhjes së ortakëve;
 - (m) thirrjen e mbledhjeve të ortakëve; përcaktimin e rendit të ditës; monitorimin e përbushjes së dispozitave që kanë lidhje me thirrjen dhe drejtimin e mbledhjes së ortakëve për shpalljen e vendimeve të vecanta;
 - (n) publikimin e shpalljeve të nevojshme përfshirë dhe publikimin e pasqyrave vjetore financiare;
 - (o) administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e rregullt dhe ruajtjen e dokumentacionit të Shoqërisë;
 - (p) marrin vendime mbi të gjitha cështjet e tjera që lidhen me aktivitetin e brendshëm të Shoqërisë dhe marrëdhëniet e saj të jashtme.

18.6 Personi i mëposhtëm do të caktohet administrator për një periudhë 5 (pesë) vjecare me të drejtë ripërtëritje:

1. **Oltjana Munega**, shtetase Shqiptar, lindur me 04/10/1984 ne Korce, banuese ne Tirane, Shqiperi, mbajtese e leternjoftimit nr. BD2712604 dhe numer personal I46004054T, madhor dhe me zotesi juridike te plote per te vepruar.

PJESA VI VITI FINANCIAR, BILANCI, FITIMI DHE HUMBJET

Neni 19 Viti finanziar, pasqyrat vjetore financiare

- 19.1 Viti finanziar i Shoqërisë zgjat 12 muaj dhe fillon në ditën e parë të Janarit dhe mbaron në ditën e tridhjetë e një të Dhjetorit. Viti i parë finanziar i Shoqërisë fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë dhe mbaron në datën e tridhjetë e një-të të Dhjetorit.



**PJESA VIII
TE PERGJITHSHME**

**Neni 22
Te pergjithshme**

- 22.1 Në rast mosmarrëveshjes të cilat lindin si pasojë e këtij Statuti ose për shkak të ligjit, ortakët do të përpinqen t'i zgjidhin ato miqësish. Nëse nuk arrihet një marrëveshje, mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridikSION përkatës.
- 22.2 Ligji zbatues është ligji shqiptar.
- 22.3. Ky statut hartohet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale.

Tirane me 04/06/2021

ORTAKU I VETEM

Oltjana Munega

Oltjana Munega
